



## KOMUNIKATË

28.12.2009

**Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, u takua në mbledhjen e 86-të dhe shqyrtoi përgatitjet e rivotimeve në komunën e Prizrenit dhe të Lipjanit. KQZ vendosi edhe për datën e mbajtjes së rivotimit në këto dy komuna. Kryetarja e KQZ-së, znj. Nesrin Lushta, fillimisht kërkoi nga anëtarët e KQZ-së miratimin e rendit të ditës dhe pas kësaj, edhe informacione nga Kryeshefi i SKQZ-së rreth përgatitjeve për rivotime në komunën e Prizrenit dhe të Lipjanit.**

**Kryeshefi i SKQZ-së, z. Xhemajl Peqani, e informoi KQZ-në për aktivitetin operacional që po bëhet për përgatitjet për rivotim në Prizren dhe Lipjan. Kryeshefi Peqani, tha se është miratuar drafti i planit operacional, ku janë të përfshira të gjitha aktivitetet që kanë të bëjnë me këtë raund të zgjedhjeve. Aktivitetet përfshihen me nxjerrjen e listës së votuesëve, trajnimin e këshillave të vendotimeve, operacionet përmes votimit me postë, dizajnimin e fletëvotimeve dhe prodhimin e tyre, votimin me nevoja të veçanta.**

**Në këtë mbledhje, është shqyrtuar edhe mundësia që sa më shpejtë që të jetë e mundur, të bëhet hetimi dhe rinumërimi i votave në komunën e Gjilanit. KQZ është angazhuar që hetimi dhe rinumërimi të bëhet në prani të stafit ndërkombëtar, të vëzhguesëve vendorë dhe ndërkombëtar, të medieve etj.**

**Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, vendosi që rivotimet për komunën e Prizrenit dhe të Lipjanit të mbahen më 31 janar.**